



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0160**  
**Data e Vendimit: 25.03.2025**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 25.03.2025, mori këtë:

## Vendim

**I. Hedhet si jo e plotë**, ankesa e OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0160, e datës 10.03.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

**II.** I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

**III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 10.03.2025, ka pranuar ankesën e OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “36 DDD objekteve të KPSH” me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 26.12.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara. Poashtu me datën 06.01.2025, AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.Hapja është planifikuar me date 16.01.2025 në 11:00

Me datën 20.01.2025 OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK e cila me datën 27.01.2025 ka publikuar vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim. Kundër vendimit të AK-së me datën 30.01.2025, OE “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/0082 (Nr. protokolli) e cila është hedhur poshtë nga OSHP për shkak se OE nuk kishte dorëzuar oferte për këtë aktivitet të prokurimit.

Me datën 19.02.2025 OE i sipërcituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK e cila është hedhur poshtë me vendim nga AK- KK Prishtinë me datën 03.03.2025. I pakënaqur me vendimin e AK-së datën 10.03.2025,Operatori Ekonomik “Doctor Exterminator” DDD SH.P.K.parashtron ankesë në OSHP

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është fare pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim.

Në vendimin e AK-së të datës 03.03.2025 lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE të sipërcituar ndër të tjera thuhet: “Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është fare pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Përmes nenit 59 paragrafit 1 të RRPP është përcaktuar se "kërkesa për rishqyrtimi mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar...". Në këtë mënyrë është gjetur se nuk janë përmbushur kushtet për të parashtruar kërkesën për rishqyrtim në kuptim të nenit 59 paragrafit 1 të RRPP për shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 26 të LPP”. Poashtu, në vendimin e AK-së thuhet: “*Duhet shtuar faktin se njoftimi mbi vendimin lidhur me këtë aktivitet është publikuar me datë 27.01.2025 apo 23 para kërkesës për rishqyrtim. Sipas nenit 60.1 të RRPP afati për kërkesë për rishqyrtim është 5 ditë pas njoftimit mbi vendimin që nënkupton se kërkesa për rishqyrtim është parashkruar me 18 ditë vonesë dhe si e tillë përpos që është e palejuar është po ashtu edhe e pasafatshme*”.

OSHP sqaron se ankesa e dorëzuar në OSHP është jo e plotë (e palejuar) dhe si e tillë nuk shqyrtohet nga OSHP, ashtu siç është paraparë shqyrtimi sipas nenit 109 të LPP-së.

Mbi bazën e asaj që OE nuk ka dorëzuar fare ofertë, OSHP konsideron se i njëjti nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së andaj ankesa e OE "Doctor Exterminator" DDD SH.P.K hedhet poshtë si jo e plotë (nuk shqyrtohet) ndërkaq vërtetohet vendimi i AK i datën 03.03.2025 për kërkesën për rishqyrtim, dhe i lejohet autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "36 DDD objekteve të KPSH" me numër të prokurimit 616-24-9594-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Kryesuesi i Sekretariatit në OSHP -ë, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Agim Sheqiri**  
U.D. Kryesues i Sekretariatit

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: